



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.332/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli, Bujar Muzaqi dhe anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Social Demokratska Unija (SDU) me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Re Demokratike (NDS) për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljës për Subjekte Politike për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar, ankesa e Social Demokratska Unija-SDU, me seli në Prizren Anr.332/2025 datë 03.02.2025, e parashtruar kundër Partia e Re Demokratike-NDS me seli në Prizren, për shkak të për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet politike për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

Me datën 03.02.2025, subjekti politik Social Demokratska Unija (SDU) ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Partia e Re Demokratike (NDS) në të cilën theksohet se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, vendet e rezervuara për çdo komunitet janë të përcaktuara paraprakisht se kush mund të konkurrojë për ato vende. Ne partinë NDS duke u nisur që nga kryetarja Emiljija Rexhepi e deri te kandidatët tjerë të cilët qartë pohojnë dhe deklarohen goranë ndërsa garojnë në vendin e Boshnjakëve. Po ashtu parashtruesi i ankesës ka theksuar se kemi bashkangjitur një dëshmi në të cilën qartë thuhet se kandidatët Goranë janë në listën e partisë që do të garojë për vendet e boshnjakëve në Kuvendin e Kosovës.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.02.2025 subjekti politik Partia e Re Demokratike (NDS) ka theksuar se Lista zgjedhore e Partisë së Re Demokratike (NDS) është certifikuar me Vendimin e

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 01/2224-2024 datë 18.12.2024. (shih kopjen e bashkangjitur të Vendimit). Ky vendim është publik dhe i disponueshëm për të gjithë personat me interes ligjor, duke siguruar kështu transparencën e plotë të procesit zgjedhor. Në fund të vendimit të sipërpërmendur, këshilla juridike qartë u është dhënë mundësia të gjithë personave që kanë interes juridik që të paraqesin ankesa brenda 48 orëve nga data e miratimit të tij. Mirëpo, asnjë person nuk e ka ushtruar këtë mundësi ligjore brenda afatit të caktuar, duke e bërë të formës së prerë Vendimin për Certifikim të Listës së Kandidatëve të NDS-së. Nisur nga kjo, çdo ankesë lidhur me përbërjen e listës së kandidatëve pas skadimit të këtij afati përbën mjet juridik të vonuar dhe si e tillë nuk mund të pranohet. Prandaj, ankesa e paraqitur nga znj. Duda Balje ne e konsiderojmë të pabazuar dhe propozojmë hedhjen e saj në tërësi.

Parashtruesi përgjigjes në ankesë ka theksuar se Pretendimet e partisë politike SDU janë të pabazuara dhe në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kushtetutën. SDU pretendon të mohoj të drejtën themelore për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur partisë politike NDS dhe kandidatëve të saj, të cilët janë certifikuar në mënyrë të rregullt nga KQZ-ja (shih nenin 6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 45 të Kushtetuta e Republikës së Kosovës).

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë po ashtu ka theksuar se partia politike SDU, e cila paraqitet si përfaqësuese e komunitetit boshnjak, ka në listën e saj disa kandidatë nga komuniteti goran. Përveç kësaj, SDU po lobonë në mënyrë aktive për të mbledhur vota brenda komunitetit goran, gjë që mund të shihet qartë nga postimet e tyre publike në mediat sociale (postimet në FB si dëshmi), përkatësisht, SDU, në bashkëpunim me Asociacionin Goranë në Maqedoninë e Veriut, në vazhdimësi ka shënjestruar komunitetin goranë gjatë gjithë fushatës zgjedhore, duke përdorur individë me ndikim për mbledhjen e votave nga goranët.

Ky është një fakt domethënës, duke pasur parasysh se në zonën e Gorës jetojnë edhe goranët edhe boshnjakët, gjë që vërtetohet nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë. Po përmendim këtë sepse SDU dhe Duda Balje, si subjekte politike që përfaqësojnë zyrtarisht komunitetin boshnjak, në mënyrë të qartë dhe të hapur po mbledhin vota pikërisht nga goranët, dhe jo nga boshnjakët e Gorës (postimet e lobimit në FB si dëshmi).

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

- Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se nga përmbajtja e ankesës rezulton se kemi të bëjmë me një kundërshtim apo pakënaqësi rreth çështjes së përfaqësimit të komuniteteve mes subjektit politik ankues dhe subjektit politik kundër të cilit është paraqitur ankesa. KQZ me vendim të veçantë ka bërë

certifikimin e subjekteve politike dhe njehërit kandidatët e këtyre subjekteve, dhe në këtë fazë çdo person i interesuar ka mundur që më ankesë ta atakojë çështjen e certifikimit përkatësisht listën e kandidatëve për deputetë përfshirë në subjektet politike të certifikuara.

Paneli vlerëson se në këtë fazë të fushatës zgjedhore, një pretendim i tillë nuk ka relevancë dhe subjekti të cilit i është referuar ankesa nuk rezulton se ka shkelur ndonjë nga rregullat e përcaktuara në nenin 34 të LZP-së.

Paneli vlerëson se në pretendimin ankimor nuk ka asnjë shkelje të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.332/2025, datë 05.02.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.